



Biografi e shkurtër

Znj. Amarilda Xhaferri (Xhyheri) ka përfunduar studimet larta dhe u diplomua “Juriste” në vitin 2007. Ka fituar titullin “Avokat” dhe është anëtare e Dhomës Kombëtare të Avokatisë që nga viti 2009. Në vitin 2011 ka përfunduar studimet e ciklit të dytë “Master i Shkencave”.

Në vitin 2016 ka përfunduar studimet doktorale dhe aktualisht mban gradën shkencore “Doktor i Shkencave” në fushën e të drejtës.

Ka një përvojë pune prej rreth 18 vitesh, me angazhime profesionale kryesisht në administratën shtetërore. Karriera e saj profesionale nisi në vitin 2007 dhe deri në vitin 2008 ushtroi detyrën si specialiste/juriste pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Vlorë. Gjatë periudhës 2008-2009, znj. Xhaferri është punësuar si konsulente ligjore pranë një Studio Kontabiliteti. Në vitin 2009, është emëruar Oficer i Policisë Gjyqësore, për tatimet, e atashuar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë, ku ushtroi detyrën deri në vitin 2011. Gjatë kësaj periudhe ushtroi njëkohësisht edhe profesionin e mësimit, në cilësinë e lektore në Fakultetin e Drejtësisë, në Universitetin “Ismail Qemali” Vlorë, profesion të cilin e ushtroi edhe në vitet në vijim, pranë “Albanian University”, në Programin e studimit të ciklit të dytë “Master i Shkencave”. Në vijim, znj. Xhaferri u emërua drejtuese sektori në Drejtorinë e Hetimit Tatimor, Tiranë, deri në qershor të vitit 2013, kur u transferua në detyrën e Drejtueses së Sektorit të Deklarimit të të Ardhurave Vjetore Personale (DIVA), në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve. Gjatë periudhës së punësimit pranë administratës tatimore, ajo ka qenë pjesë e disa grupeve ndërsektoriale të punës, ka kryer një sërë trajnimesh brenda dhe jashtë vendit, si dhe është autore dhe bashkautore e një sërë artikujsh të botuar në revista kombëtare dhe ndërkombëtare. Nga viti 2014 deri në vitin 2021, znj. Xhaferri ka qenë e punësuar pranë Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Zotëron shumë mirë gjuhën angleze dhe atë italiane, si dhe ka njohuri të gjuhës frënge.

Në vitin 2021, ajo është emëruar Këshilltare Ligjore në Njësinë Ligjore pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit. Nga shtatori i vitit 2024, është pjesë e Njësisë së Shërbimit Ligjor pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelit, me detyrën e Këshilltares Ligjore.